



KONTRATË SHIT-BLERJE E KUOTAVE TË KAPITALIT
Në bazë të nenit 705 të K.Civil

Sot më datë 02 Qershor 2014 (dymijë e katërbëdhjetë) ditën e Hënë para meje Noterit **SOKOL SH. MALAJ**, Noter në dhomën e Noterisë Tiranë me seli në Rr."L.Gurakuqi" u paraqitën personalisht:—

PALA SHITËSE :

Znj. NETA MARKU e bija Kolë dhe Prenë lindur në Shkodër më 30.01.1957 banuese në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, —24480 Grand River, Detroit, e paisur me Pasaportën Amerikane Nr 078413523. Aksionere e kesaj shoqërie me 4.51% të Aksioneve ne kete Shoqëri Anonime, e cila ne baze te Prokurës se Posaçme të datës 22 Dhjetor 2012 me Notere Patricia A MCCLELLAN Notere në USA Michigan . me vulën Apostille të datës 26.12.2012 përfaqësohet nga aksioneri tjetër në ortakëri—

Z. PËLLUMB GJOKA i biri i Kolë dhe Prenë lindur në Shkodër më 08.04.1974 banues në Tiranë, Rr."Luigj Gurakuqi" Pall 4 katësh, i identifikuar me kartën e identitetit #029101929# me Nr Personal #H48408126Q#, aktualisht përdorues i telefonit 0035568208000.—

PALA BLERËSE :

Z. PËLLUMB GJOKA i biri i Kolë dhe Prenë lindur në Shkodër më 08.04.1974 banues në Tiranë, Rr."Luigj Gurakuqi" Pall 4 katësh, i identifikuar me kartën e identitetit #029101929# me Nr Personal #H48408126Q#, aktualisht përdorues i telefonit 0035568208000.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilet deklaruan se lidhin Kontratën e shitblerjes te kuotave te kapitalit me kushtet si vijon: —

Pala shitëse përmes përfaqësuesit të saj, deklaroi se është aksionere ne kuoten prej 4,51% ne Shoqërinë "ShB" sha, e regjistruar si person juridik pranë Q.K.R më datë 24.12.2010, e pajisur me numër unik të identifikimit (NIPT) **L02424005D**, me adresë Tiranë, Rr"Luigj Gurakuqi"; Pallati 3 katësh, mbrapa Tirana Bank.—

Përmes përfaqësuesit të saj shitësja Neta MARKU, me vullnetin e saj të lirë e të plotë i shprehur ky me **Vendimin** Nr—1, të datës 02.06.2014 të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë "SHB" Sh.a, ka vendosur —shitjen me Akt Noterial të pjesës së saj që ajo zotëron në shoqërinë "ShB" sha prej **4,51%** ose prej **23 aksioneve**—, në favor të Z. Pellumb Gjoka, duke e humbur pronesinë në këtë Shoqëri.—

Në bazë të marrëveshjes se arritur mes paleve jashte kesaj zyre,shitësja Neta MARKU përmes përfaqësuesit të saj ligjor deklaroi se është dakort që kuotën/pjesën e saj e kapitalit prej **4,51%** ose **23,00 aksione** që ajo zotëron në shoqërinë "**SHB**" sha, t'i shesë blerësit Pellumb Gjoka kuotën në vlerën **2.300.000 Lekë** (dy milion e treqind mijë).—

[Signature]

Pala Shitëse përmes përfaqësuesit të saj ligjor deklaroi se është likuiduar plotësisht jashtë kësaj zyre për vlerën prej **2.300.000 Lekë** (dy milion e treqind mijë) para nënshkrimit të këtij akti.—

Edhe Blerësi, Pëllumb GJOKA deklaroi se pranon të blejë këtë kuotë të kapitalit në shoqërinë e mësipërme ne çmimin që ata kanë caktuar ne mareveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likuiduar plotësisht shitëses Neta Marku, jashtë kësaj Zyre cash.—

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej 2.300.000 Lekë (dy milion e treqind mijë) shitësja Neta Marku e humbet të drejtën e pronësisë për **23,00 aksione** që ajo zotëronte në shoqërinë tregëtare "**SHB**" shpk, ndërsa Blerësi Z.Pëllumb GJOKA fiton të drejtën e pronësisë përkatësisht:

Znj. Neta MARKU e humbet tërësisht të drejtën e pronësisë për aksionet e saj në shoqërinë aksionere "ShB" sh.a

Z.Pëllumb GJOKA do te ketënë pronesi kuotën **40,59%** të Aksioneve

Z. Kolë GJOKA do ti mbesë në pronesi kuota **59,41%** të Aksioneve

Bleresi është i detyruar të paraqesë pranë **Q. K. R. Vendimin** e asamblese se aksionereve dhe aktin noterial te shitjes se kuotave në favor të aksionerit Z. Pëllumb GJOKA.—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo kontrate shitje e kuotave te kapitalit, bazuar në Nenin 705 të Kodit Civil, e cila pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të palëve, u nënshkrua prej tyre në praninë time sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

PALA SHITËSE

Znj. NETA MARKU

e përfaqësuar nga **Z.PËLLUMB GJOKA**

Pellumb Gjoka
[Signature]

PALA BLERËSE

Z.PËLLUMB GJOKA

Pellumb Gjoka
[Signature]

NOTER

SOKOL SH. MALAJ

NOTER
SOKOL SH. MALAJ

RR.Luigj Gurakuqi P.2
TIRANE / ALBANIA
Tel. 00355 (4) 2229632
Cel. 00355 68 40 5554



TAKSA E PULLES
U PAGUA